

**RAPORT PËR PROCESIN E VERIFIKIMIT NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
TË PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE DHE KRITEREVE PROFESIONALE
E MORALE PËR KANDIDATËT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN E LARTË TË
PROKURORISË QË PËRFAQËSON SHOQËRINË CIVILE**

**I. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE E PROCESIT TË VLERËSIMIT
NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organ i parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 149 i saj parashikon ngritjen e tij si dhe përcakton dhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm në procesin e konstituimit të këtij Këshilli.

Referuar këtij neni:

“5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kandidaturave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, si dhe vlerëson kriteret profesionale e morale për anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe përgatit listën. Në rast se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për t’u zgjedhur, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nuk i përfshin emrat e tyre në listë.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit pas përfundimit të verifikimeve, i dërgon menjëherë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale nënkomisionit, sipas paragrafit 7 të këtij neni.”

Detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm në këtë proces janë detajuar në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Konkretisht në pikën 2 të nenit 156 “Përzgjedhja e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga shoqëria civile”, parashikohet se: “Rregullat e parashikuara në nenin 35, nga pika 2 deri në pikën 19, të këtij ligji, zbatohen edhe për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e përfaqësuesve të shoqërisë civile”.

Sa më sipër, në referim të procedurës që ndiqet sipas hapave proceduriale që parashikon neni 35 edhe për përzgjedhjen e kandidatëve nga shoqëria civile :

“2. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga dita e paraqitjes së listës dhe dokumentacionit shoqërues, të regjistruar sipas pikës 1, të këtij neni, verifikon, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe neni 152 i këtij ligji për zgjedhjen e anëtarit të KLP nga shoqëria civile.. Sekretari i Përgjithshëm përjashton kandidatët, të cilët, sipas vlerësimit të tij, nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj.

3. Nëse dokumentacioni i kandidatit nuk është i plotë për të vlerësuar plotësimin e kushteve kushtetuese dhe ligjore, si dhe të kriterëve profesionale e morale, sipas nenit 152 të këtij ligji, Sekretari i Përgjithshëm i kërkon kandidatit që brenda 5 ditëve të bëjë plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumenteve shtesë. Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumentacionit shtesë i dërgohet kandidatit në adresën elektronike të deklaruar.

4. Mosparaqitja e dokumentacionit plotësues ose dokumentacionit shtesë në përfundim të afatit 5-ditor, nuk pezullon procesin e regjistrimit përfundimtar në Kuvend të listës së kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues të saj.

5. Data në të cilën plotësohet dokumentacioni i kërkuar, ose afati i përcaktuar për plotësimin, konsiderohet dhe dita e paraqitjes dhe regjistrimit të listës së kandidatëve dhe dokumentacionit shoqëruar në Kuvend. Paraqitja përfundimtare dokumentohet me një numër regjistrimi nga zyra e protokollit në Kuvend.

6. Sekretari i Përgjithshëm vlerëson kriteret profesionale e morale vetëm për kandidatët të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Vlerësimi i kriterëve profesionale e morale të kandidatëve nga Sekretari i Përgjithshëm bëhet sipas kriterëve të parashikuara në nenin 34 (në rastin e kandidatëve për anëtar të KLP-së, sipas nenit 132 të këtij ligji).

7. Sekretari i Përgjithshëm, në përfundim të procedurës së parashikuar në pikat 2 dhe 6, të këtij neni, harton dokumentet e mëposhtme:

a) një listë me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

b) një listë me emrat e kandidatëve, të cilët, sipas vlerësimit të tij, nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Lista e kandidatëve të përjashtuar përmban emrat e tyre dhe arsyet e përjashtimit për secilin;

c) një raport me shkrim, ku vlerësohet shkalla e përmbushjes së kriterëve profesionale e morale nga secili kandidat, mbështetur në procesin e zhvilluar dhe raportin e përgatitur nga Komisioni i Shoqërisë Civile.

8. Kandidatët e përjashtuar njoftohen me shkrim, në mënyrë individuale dhe të arsyetuara për përjashtimin në adresën e tyre elektronike të deklaruar.

9. Sekretari i Përgjithshëm i dërgon komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, brenda ditës së nesërme nga dita e hartimit të dokumenteve të parashikuara në pikën 7, të këtij neni, listat, së bashku me raportin e parashikuar në pikën 7, shkronja "c", të këtij neni, si dhe dokumentacionin për secilin kandidat. Listat dhe raportin bëhen publikë në faqen zyrtare të Kuvendit jo më vonë se 10 ditë pas regjistrimit të listës së kandidatëve në Kuvend.

10. Në zbatimin e detyrave të parashikuara në pikat 1 deri në 6, të këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm mbështetet nga shërbimet e Kuvendit."

Vlerësimi dhe verifikimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit ka filluar menjëherë pas depozitimit në Kuvend nga Komisioni i Shoqërisë Civile pranë Avokatit të Popullit të dokumentacionit dhe të listës së kandidatëve për KLP nga rradhët e shoqërisë civile.

II. KRONOLOGJIA E PROCESIT TË APLIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KLP NGA ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE DHE HAPAT PROCEDURIALE TË NDËRMARRA NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I KUVENDIT

Më datë 13 Janar 2017, ka startuar nisja e procedurave ligjore që bazuar në tagrat kushtetuese dhe ligjore, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit zbatoi për aplikimet e kandidatëve jogjyqtarë dhe joprokurorë për KLGj dhe KLP për tre kategoritë përkatëse për çdo organ (avokati, trupa e pedagogeve dhe shoqeri civile).

Në këtë datë, (13 janar 2017) ashtu si dhe për kategoritë e tjera, Kuvendi ka publikuar edhe shpalljen e vendit vakant dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit të kandidatëve nga shoqëria civile për KLP.

Në vijim të kësaj shpalljeje, institucionet e ngarkuara nga ligji vijuan me procedurat përkatëse të përcaktuara nga nenet 152-155 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Organi përzgjedhës që përcakton ligji, në këtë rast Komisioni për Shoqërinë Civile i ngritur pranë Avokatit të Popullit, ka kryer mbledhjen e tij të parë më datë 27 Shkurt 2017 ku ka nisur edhe punën e tij për fillimin e procedurave të para shqyrtuese të kandidatëve aplikues për KLGJ dhe KLP nga shoqëria civile .

Gjatë periudhës Mars-Nëntor 2017, procesi i aplikimeve dhe ai i verifikimit të kandidaturave rezultoi që të ishte në një numër total të kandidaturave të paraqitura për KLP-në, më të vogël se numri minimal i kandidaturave që kërkohen nga neni 156 i ligjit nr. 115/2016 për t'iu paraqitur Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit nga Komisioni i Shoqërisë Civile, sipas të cilit lista që përcillet nga Komisioni i Shoqërisë Civile, duhet të ketë jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante (*jo më pak se 3 për një vend anëtar në KLP nga shoqëria civile*).

Për rrjedhojë, mbështetur në kërkesat e arsytura të Komisionit të Shoqërisë Civile, ka patur një proces të pandërprerë dhe të përsëritur të disa rishpalljeve : 5 rishpallje, ndërsa duke përfshirë dhe shpalljen për herë të parë në Janar 2017, në total 6 shpallje të thirrura nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga kandidatë të angazhuar në shoqërinë civile për anëtarë të KLP-së dhe që plotësonin kushtet ligjore.

Në përfundim të rishpalljes për herë të së pestë për kandidatë të rinj për KLP nga rradhët e shoqërisë civile, (datë 15 Nëntor 2017 me afat dorëzimi të shprehjeve të interesit më datë 30 Nëntor 2017) rezultoi se në përfundim të këtij afati, kishin shprehur interesin kandidatë të rinj.

Në vijim, organi i ngarkuar nga ligji, Komisioni i Shoqërisë Civile pranë Avokatit të Popullit, njoftoi Kuvendin me shkresën nr. 192, dt.19.12.2017 se nga ky proces i ri i aplikimit, nga 5 kandidatë që aplikuan në këtë thirrje, kanë rezultuar se plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore 3 kandidatë të rinj.

Së bashku me një kandidat të vlerësuar të vlefshëm nga procesi i mëparshëm i aplikimeve nga ana e Komisionit të Shoqërisë Civile, lista finale e kandidatëve nga shoqëria civile prej 4 kandidatësh që plotësonin kushtet ligjore sipas shqyrtimit të bërë nga Komisioni i Shoqërisë Civile, u bë publike në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit dhe të Kuvendit të Shqipërisë. Kjo është një listë që plotëson kushtin ligjor parashikuar në nenin 156 të ligjit 115/2016 sipas të cilit Komisioni për Shoqërinë Civile pranë Avokatit të Popullit i përcjell Sekretarit të

Përgjithshëm të Kuvendit një listë me jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante (*pra jo më pak se tre kandidatë për një anëtar nga shoqëria civile për KLP.*)

Gjithashtu në këtë njoftim të bërë edhe publik, Komisioni i Shoqërisë Civile informoi Kuvendin për datën kur do të zhvillohej seanca dëgjimore (datë 20 dhjetor 2017) me të tre kandidatët që iu përgjigjën thirrjes së gjashtë dhe që kishin rezultuar nga vlerësimi i Komisionit të Shoqërisë Civile se kanë pëmbushur kriteret formale ligjore.

Në mbështetje të nenit 156 dhe 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me shkresën nr. 193/1 Prot, datë 29.12.2017, Komisioni i Shoqërisë Civile, ka përcjellë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, listën e 4 (katër) kandidatëve që pëmbushin kriteret ligjore sipas vlerësimit të Komisionit dhe që kanë marrë pikët më të larta, si dhe listën e 11 (njëmbëdhjetë) kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore:

Lista e kandidatëve të kualifikuar për të vijuar kandidimin në plotësim të kushteve ligjore sipas vlerësimit të Komisionit të Shoqërisë Civile dhe renditja sipas pikëve :

1.	Entela Baci (Hoxhaj)	81 pikë
2.	Andi Muratej	79,5 pikë
3.	Mimoza Qinami	79 pikë
4.	Alfred Balla	63 pikë

Lista e kandidatëve të përjashtuar nga kandidimi sipas vlerësimit të Komisionit të Shoqërisë Civile :

EMRI	MBIEMRI
1. Drita	Avdyli
2. Tartar	Bazaj
3. Bledar	Bejri
4. Mevlut	Derdi
5. Bledar	Ilia
6. Kostandin	Kazanxhi
7. Plarent	Ndreca
8. Vasil	Shandro
9. Arban	Tutulani
10. Vladimir	Vladaj
11. Lindita	Xhillari

Gjithashtu, Komisioni i Shoqërisë Civile ka përcjellë raportin e tij të vlerësimit i cili përfshin dokumentacionin përkatës për çdo kandidat mbi të cilën Komisioni ka bërë verifikimin paraprak dhe vlerësimin si dhe të gjithë korrespondencën dhe vendimet e Komisionit të

hartuara dhe miratuara gjatë gjithë procedurës së zhvilluar për këtë proces vlerësimi paraprak të kandidatëve

III. PROCESI I VERIFIKIMIT NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM TË PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE SIPAS NENIT 152 DHE 287 TË LIGJIT NR. 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”

A) Procedura e ndjekur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit pas paraqitjes nga Komisioni i Shoqërisë Civile pranë Avokatit të Popullit të dosjeve të kandidatëve për KLP nga Shoqëria Civile.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të neneve 156 dhe 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas depozitimit të listës së kandidatëve nga radhët e përfaqësuesve të shoqërisë civile për anëtarë të KLP-së dhe dosjeve përkatëse, ka filluar menjëherë punën për verifikimin e plotësisë të kushteve ligjore të kandidatëve, bazuar nëparashikimet e Kushtetutës dhe nenit 152 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Njëkohësisht, në mbështetje të nenit 287, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, në datë 03.01.2018, me shkresën Nr.2054/12, i ka përcjellë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) kopje të dokumentacionit të depozituar nga Komisioni i Shoqërisë Civile, pranë Avokatit të Popullit dhe të administruar për çdo kandidat në Kuvendin e Shqipërisë .

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në pikën 2 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, ka vijuar me procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të ndodhur në dosjen personale të secilit kandidat.

Bazuar në pikat 3 dhe 4 të nenit 35 të ligjit të sipërcituar, Sekretari i Përgjithshëm, gjatë verifikimit të plotësisë të kushteve të parashikuara nga Kushtetuta dhe nga neni 152 i ligjit nr. 115/2016, ka konstatuar se disa kandidatë, të cilët sipas Komisionit të Shoqërisë Civile janë vlerësuar se plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore, kishin disa paqartësi në dokumentacionin ligjor, që provon plotësimin e këtyre kushteve.

Për sa më sipër, Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në parashikimet e pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, u ka komunikuar këtyre kandidatëve në datat 5.01.2018 (nr.2054/23) dhe 8.01.2018, (nr.2054/25) përmes postës elektronike personale të deklaruar në momentin dhe dokumentacionin e aplikimit, nevojën për plotësimin e dokumentacionit provues në dosje brenda afateve ligjore për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në përgjigje të kërkesës së Kuvendit, vetë kandidatët në mënyrë individuale, më datë 9 Janar 2018, kanë plotësuar dosjet individuale me dokumentacionin e kërkuar.

Ndërkohë gjatë përmbushjes së këtij procesi, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, pasi konstatoi se Komisioni i Shoqërisë Civile nuk kishte kryer korrespondenca me institucionet e ndryshme publike për kontrollin e kushteve të tjera ligjore, në zbatim të ushtrimit të kompetencave të tij ligjore, në kushtet kur ndodhet në fazën e verifikimit sa më të plotë dhe të sigurt lidhur me plotësimin e kushteve ligjore për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar nga shoqëria civile, ka kërkuar pranë institucioneve përgjegjëse që ngarkon ligji të listuara më poshtë, kryerjen e verifikimeve përkatëse sipas kuadrit ligjor në fuqi, për të 15 kandidaturat që kanë aplikuar për KLP nga shoqëria civile:

- Prokuroria e Përgjithshme;
- Autoriteti Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;
- Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- Shërbimi Informativ i Shtetit.

Konkretisht nëpërmjet shkresave:

- Nr.2054/15, datë 03.01.2018, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë ka kërkuar pranë Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, verifikimin e plotësimin nga kandidatët të kushtit ligjor të parashikuar nga neni 152 pika 2 gërma “g” të ligjit nr. 115/2016, sipas të cilit citojmë: “kandidatët nuk duhet të kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të Ish-Sigurimit të Shtetit përpara 2 Korrikut 1991”.

Në përgjigje të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet shkresave nr.2054/20 dhe 2054/22, datë 05.01.2018, ka informuar se: “nuk figuron të ketë materiale të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit për të 15 kandidatët që kanë aplikuar për tu zgjedhur anëtar të KLP nga shoqëria civile, sipas përcaktimeve të nenit 29 pika 2 të ligjit nr.45/2015”.

- Nr.2054/16, datë 03.01.2018, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë ka kërkuar informacion Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI). Në vijim të përgjigjes përmes shkresës Nr.2054/24, datë 8.1.2018, ILDKPKI shprehet se 8 nga kandidatët për anëtarë të KLP nga shoqëria civile nuk kanë qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI. Ndërsa 7 prej kandidaturave të cilët kanë qenë subjekte të ligjit 9049/2003, nga kontrolli i kryer prej këtij institucioni, kanë rezultuar pa probleme, pra për to nuk janë marrë masa administrative gjorbë apo kryer kallëzime penale.

- Për të verifikuar integritetin e kandidaturave, Sekretari i Përgjithshëm i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën nr.2054/13, datë 03.01.2018, duke i përcjellë

formularët e deklaramit të të 15 kandidatëve plotësuar nga secili prej tyre sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, dhe ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar. Me qëllim respektimin e afateve ligjore për kryerjen e vlerësimit nga Sekretari i Përgjithshëm, i është kërkuar Institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme kthimi i përgjigjes brenda datës 8.01.2018. Njëpërmjet shkresës nr.2054/21, datë 05.01.2018, Prokuroria e Përgjithshme ka informuar se ligji 138/2015 i ka njohur Prokurorisë së Përgjithshme kryerjen e verifikimeve të plota të thelluara e të gjithanshme për një periudhë 3 mujore.

Pavarësisht kësaj, Prokuroria e Përgjithshme informon se kërkesa e Kuvendit do të vlerësohet me përparësi dhe ka përcjellë edhe verifikimet për disa prej kandidatëve për të cilët Prokuroria ishte shprehur më parë me vendim. Nga përgjigjia e Prokurorisë janë përcjellë verifikimet për 7 kandidatë të skualifikuar nga Komisioni i Shoqërisë Civile dhe vetëm për një kandidat që rezultonte i kualifikuar nga Komisioni.

Për të gjithë këta kandidatë të verifikuar nga Prokuroria, nuk rezultonte që këta kandidatë të ishin në kushtet e ndalimit për të kandiduar në poste publike sipas kufizimeve të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, dhe ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar. Ndërkohë për kandidatët e tjerë vijon verifikimi nga ky organ.

Nga ana e tij, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në respektim të detyrimeve të organit kompetent që ka përcaktuar ligji 138/2015 për administrimin e formularëve të vetdeklarimit të kandidatëve që zgjidhen në institucionet e pavarura kushtetuese nga Kuvendi, në këtë rast Kuvendi, ka marrë masat duke publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit formularët e vetdeklarimit të 15 kandidatëve në kuadër të zbatimit të ligjit 138/2015 dhe Vendimit Nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë të dalë në zbatim të tij.

Sic dhe përcaktohet në këtë vendim të Kuvendit në kuadër të transparencës dhe informimit publik të këtij procesi verifikimi, synohet realizimi në kohë të mjaftueshme i tij dhe për aq sa është i mundur, përpara kandidimit apo votimit të kandidatëve në këto funksione publike kaq të larta.

Megjithatë, bazuar në përcaktimet e Kreut V të Vendimit të Kuvendit nr 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” *“Procedura e verifikimit, sipas kësaj pike, nuk pengon vijimin e procedurave për zgjedhjen, emërimin apo ushtrimin e funksionit”*.

- Nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në kthim përgjigje të kërkesës për informacion dërguar me nr.2054/17, dt.3.01.2018, ka ardhur përgjigja me shkresën nr 2054/19 datë 05.01.2018, sipas të cilës nga verifikimi i gjëndjes gjyqësore, të 15 kandidatët kanë rezultuar të gjithë të padënuar nga gjykatat penale shqiptare.

- Në vijim të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit nr.2054/14 dt.3.1.2018, nga Shërbimi Informativ i Shtetit ka ardhur përgjigja me shkresën nr.1, dt.8.1.2018 e cila përmbante informacion “SEKRET”.

Është e nevojshme të sqarohet se në kushtet kur një informacion i përcjellë nga organet përgjegjëse të ligjit, ishte i klasifikuar “SEKRET”, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit e trajtoi atë në përputhje me ligjin Nr.8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror” i ndryshuar, dhe ligjin Nr.8391, datë 28.10.1998, “Për Shërbimin Informativ të Shtetit” i ndryshuar.

B) Përcjellja në mënyrë të menjëhershme Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) i dokumentacionit dhe të dhënave të administruara për kandidatët.

Për të gjithë procedurën e mbledhjes së informacioneve gjatë fazës së verifikimit të kandidaturave, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë ka informuar në vazhdimësi dhe në kohë të menjëhershme ONM si në rrugë zyrtare ashtu dhe atë elektronike duke filluar me dërgimin e të gjithë dokumentacionit të prodhuar nga Komisioni i Shoqërisë Civile së bashku me dosjet fizike të kandidatëve, më tej edhe kopje të dokumenteve plotësuese të dorëzuara nga kandidatët pas kërkesës për dërgim të dokumentacionit plotësues si dhe të gjitha korrespondencat me institucionet përgjegjëse të zbatimit të ligjit, ku për përgjigjen e fundit mbërritur nga një institucion ligjzbatues, informacioni u trajtua në përputhje me ligjin për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe ligjin për Shërbimin Informativ të Shtetit.*(shpjeguar më lart)*

Përkatesisht ONM i janë përcjellë të gjitha korrespondencat e lartcituara prej kandidatëve si dhe institucioneve të ndryshme shtetërore e të pavarura me shkresat nr. 2054/12, datë 03.01.2018, 2054/18, datë 04.01.2018, 2054/27 , datë 9.1.2018, si dhe nr.2, datë 10.1.2018.

Informacioni i fundit dërguar ONM nga Sekretari i Përgjithshëm ishte përmes shkresës me nr. 2 Prot, datë 10 Janar 2018, më shënimin e klasifikuar : “SEKRET” e cila pasqyrore një info të përmbledhur të përmbajtjes së materialit të vënë në dispozicion nga institucioni përgjegjës i ligjit për disa nga kandidatët e kualifikuar dhe disa nga ata të skualifikuar.

Ndodhur në kushtet e parashikimeve detyruese ligjore dhe afateve prekluzive, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, ka vijuar me kryerjen e vlerësimit të plotësimit të kushteve kushteve ligjore dhe shkallës së përmbushjes së kriterëve profesionale-morale, pavarësisht faktit se nga Prokuroria e Përgjithshme nuk është kthyer një përgjigje për të gjitha rezultatet e verifikimeve që janë duke u kryer pranë këtij institucioni.*(shpjeguar më lart veprimet e ndërmarra nga organet përgjegjëse lidhur me zbatimin e këtij ligji)*

Referuar parashikimeve të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm duhet të bëjë publike listat me kandidatët që plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore, listat me kandidatët që nuk kualifikohen dhe raportin e vlerësimit të shkallës së përmbushjes së kriterëve

profesionale dhe morale brenda 10 ditëve nga regjistrimi i listës së kandidatëve (nga data e plotësimit të dokumentacionit nga kandidatët, pra brenda datës 19 Janar 2018).

C) VERIFIKIMI I PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE NGA KANDIDATËT

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 35 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, siç është parashtruar më lart,

-pasi ka verifikuar nëse dokumentacioni i kandidatëve është i plotë, duke kërkuar nga kandidatët plotësimet përkatëse;

-pasi administroi dokumentacionin e plotësuar apo shtesë, nga kandidatët të cilëve ju drejtua për plotësim të dokumentacionit;

-pasi ka verifikuar dhe vlerësuar plotësimin e kushteve të parashikuara nga Kushtetuta dhe neni 152, pika 2, i ligjit 115/2016, si dhe të dokumentacionit që shoqëron shprehjen e interesit, të parashikuar në pikën 3 të nenit 154 të po këtij ligji.

-si dhe pas përgjigjeve të institucioneve publike të cilave iu drejtua me shkresë zyrtare për verifikim të kushteve ligjore për të 15 kandidatët aplikues : Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive, Prokuroria e Përgjithshme dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, SHISH, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve,

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vijoi me vlerësimin e tij të kandidaturave i cili pasqyrohet në vazhdim:

1.) Kushtet ligjore sipas nenit 152 pika 1, 2 dhe 4 janë:

Pika 1 : Kuvendi zgjedh 1 anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga anëtarët e organizatave të shoqërisë civile, të rregjistruar sipas legjislacionit përkatës, të cilat punojnë në fushën e sistemit të drejtësisë ose të të drejtave të njeriut dhe që kanë zbatuar projekte në këtë fushë të paktën 5 vitet e fundit.

Pika 2: Kandidatët nga shoqëria civile duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë shtetas shqiptar;*
- b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të kenë marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;*
- c) të kenë të paktën 15 vite përvojë pune në profesion si jurist;*
- ç) të kenë një profil të spikatur shoqëror, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut;*

- d) në kohën e kandidimit të jenë të punësuar ose të angazhuar për të paktën 5 vjet, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme pa ndërprerje, në një organizatë të shoqërisë civile për fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut;
- dh) në kohën e kandidimit të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit për të paktën 2 vjet, me përjashtim të atyre të angazhuar në organizataose klinika që ofrojnë ndihmën ligjore falas për funksion të organizatës;
- e) të mos jenë kandidatë të propozuar nga avokatia ose trupa e pedagogëve të drejtësisë;
- ë) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
- f) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike, gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit;
- g) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të shërbimeve të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- gj) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve të inteligjencës;
- h) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

Pika 4: Ka të drejtë të kandidojëçdo anëtar i organizatës së shoqërisë civile që plotëson kushtet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe që siguron mbështetjen e së paku 3 organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut.

➤ **SHPJEGUESE PËR NATYRËN E VLERËSIMIT TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM NË RAPORT ME VLERËSIMET E ONM-SË DHE KOMISIONIT TË SHOQËRISË CIVILE I NGRITUR SIPAS PËRCAKTIMEVE LIGJORE :**

Vlen të theksohet se gjatë të gjithë procedurave të deritanishme të kryera sipas kompetencave të dhëna nga ligji 115/2016 për secilin nga organet e verifikimit dhe vlerësimit paraprak për kandidatët jogjyqtarë dhe joprokurorë që janë : *Komisionet Ad-Hoc për secilën kategori kandidatësh pranë Avokatit të Popullit apo të trupës së pedagogëve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe ONM, vlerësimi i secilit prej tyre është i pavarur dhe i pakushtëzuar nga njëri-tjetri.*

Komisioni i Shoqërisë Civile është organi i parë i krijuar ad-hoc që parashikon ligji 115/2016 i cili për shkak se krijohet nga përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, kryen edhe fazën e parë të verifikimit paraprak të kandidatëve që vijnë nga këto rradhë bazuar në përcaktimet e ligjit.

Ai kryen një sërë procedurash dhe vendimarrjesh sipas rregullave të funksionimit të organeve kolegjiale dhe zhvillon procese të ndryshme në funksion të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët si dhe zhvillon seanca dëgjimore të hapura publike me kandidatët e kualifikuar në prani të medias dhe vëzhguesve të tjerë të organizatave të shoqërisë civile që shprehin interes për procesin.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit është i vetmi organ verifikimi dhe vlerësimi për kandidatët për anëtarë jogjyqtarë për KLGJ dhe joprokurorë për KLP i cili parashikohet nga Kushtetuta në nenin 147 dhe 149 të saj.

ONM është një organ i parashikuar në dispozitat kalimtare të Kushtetutës sipas nenit 179 të saj (pika 5 dhe 6) ku përcaktohet se për emërimet e para në KLGJ dhe KLP verifikimi i kandidatëve sipas nenit 147 dhe 149 të Kushtetutës do të kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe ONM.

Po ashtu, në dispozitën kalimtare të ligjit 115/2016, neni 287 i tij, parashikohet i njëjti referim se për emërimet e para, verifikimi i kandidatëve joprokurorë kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe ONM.

Kështu, lidhur me raportin e ONM-së, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka detyrimin bazuar në nenin 287, pika 4 të ligjit 115/2016, që t'i përcjellë Komisionit të përhershëm për çështjet ligjore në Kuvend, listat e kandidatëve të vlerësuar prej tij se plotësojnë kushtet ligjore dhe listat e atyre që sipas vlerësimit të tij nuk plotësojnë kushtet ligjore. Në këto lista Sekretari i Përgjithshëm reflekton edhe vlerësimin e përcjellë nga ONM lidhur me listat e kualifikuara dhe të pakualifikuara sipas vlerësimit që ka kryer ONM.

Një kopje e këtyre listave të ONM i vihet në dispozicion edhe komisionit të përhershëm për çështjet ligjore në Kuvend.

Ashtu sic edhe cituar në opinionin e ONM lidhur me kandidatët për KLP nga shoqëria civile, ku ekspertët e ONM-së shprehin se “vlerësimi i kryer nga KShC-ja nuk është i detyrueshëm për SPK-në dhe ONM-në. Si rrjedhim, mund të supozojmë se, nëse është e përshtatshme, ato mund të zëvendësojnë dhe/ose të integrohen dhe/ose të plotësojnë rregullat dhe kriteret e përcaktuara dhe të ndjekura nga Komisioni i Shoqërisë Civile”, vlerësimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit nuk është i kushtëzuar nga vlerësimi i ONM po ashtu dhe nga ai i Komisionit të Shoqërisë Civile.

ONM kryen një vlerësim si nga ana e metodologjisë ashtu dhe nga pikëpamja e vlerësimit të elementeve ligjore dhe atyre profesional e moral të ndryshëm nga metodologjia dhe vlerësimi që kryen Sekretari i Përgjithshëm sipas përcaktimeve ligjore bazuar në përcaktimet e nenit 35 të ligjit pika 6 e tij Sekretari i Përgjithshëm:

“vlerëson kriteret profesionale e morale vetëm për ata kandidatë të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe nga ky ligj” dhe pasi ka përfunduar edhe këtë procedurë, harton listat e tij të kandidatëve që sipas vlerësimit të tij i plotësojnë ose jo kushtet ligjore.

Ndërkohë që bazuar në gjurmën “c” të pikës 8 të nenit 35, Sekretari i Përgjithshëm përgatit raportin e tij me shkrim, ku vlerësohet shkalla e përmbushjes së kriterëve morale e profesionale nga secili kandidat, *mbështetur në procesin e zhvilluar dhe raportin e përgatitur nga Komisioni i Shoqërisë Civile.*

Për sa më lart, është e kuptueshme që në mënyrën e ushtrimit të tagrave dhe pozicioneve që ka parashikuar Kushtetuta dhe ligji 115/2016, për secilin nga këto organe në këtë proces paraprak të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave për KLP dhe KLGJ nga joprokurorë dhe jogjyqtarë, vlerësimi i secilit prej tyre, është i pavarur dhe për pasojë mund të rezultojë që dy organet që kryejnë verifikim në fazën e dytë pas Komisionit të Shoqërisë Civile (ONM dhe Sekretari i Përgjithshëm të Kuvendit) të kenë vlerësime të ndryshme ose të ndërthurura apo të mbështetura në disa komponentë, por në asnjë rast të detyrueshme për ta në raport me vlerësimin e kryer nga Komisioni i Shoqërisë Civile po ashtu edhe vlerësimet e pavarura midis vet ONM dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE DHE ARGUMENTIMI PËRKATËS

I. Kandidati Andi Muratej

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatit ka rezultuar se pavarësisht procedurës së ndjekur nga Komisioni i Shoqërisë Civile, ishte e nevojshme të qartësohej më saktë dokumentacioni provues që vërteton plotësimin e kushtit ligjor referuar gjurmës “d” të pikës 2 të nenit 152 të ligjit 115/2016, sipas të cilit: *“Kandidati në kohën e kandidimit, të jetë i punësuar ose i angazhuar për të paktën 5 vjet, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme pa ndërprerje, në një organizatë të shoqërisë civile për fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut”.*

Në përgjigje të shkresës nr.2054/23, datë 05.01.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm, për plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit, kandidati ka paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor 5 ditor për plotësimin e dokumentacionit.(shkresa 2054/26, datë 8.1.2018)

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Andi Muratej plotëson kushtet ligjore të nenit 152 të ligjit 115/2016, për të qenë kandidat për anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ky vlerësim është i ndryshëm nga vlerësimi që ka dhënë ONM për këtë kandidat.

Në vlerësimin e ONM për këtë kandidat citohet se : “Dosja e kandidatit dëshmon se angazhimi i tij në shoqërinë civile ka filluar vetëm në 2014, kur ai filloi të punonte si menaxher/koordinator projekti tek Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Kjo nuk është në përputhje me kriterin e parashikuar në nenin 152.1 dhe nenin 152.2.d) të ligjit, i cili kërkon një angazhim

prej së paku prej 5 vitesh në një organizatë të shoqërisë civile përpara dërgimit të kërkesës për t'u bërë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë".

"Përveç kësaj, situata e kandidatit në aspektin profesional është shumë e paqartë. Në dosjen e tij ka disa kontrata ndërmjet Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe kandidatit, në cilësinë e tij si 'avokat', ndërkohë që kërkesat ligjore të nenit 152.2. dh) nuk e lejojnë asnjë aktivitet si 'avokat' për së paku dy vjet përpara dërgimit të kërkesës".

Argumentet ligjore të Sekretarit të Përgjithshëm për këtë kandidat janë :

- Kandidati Andi Muratej vërtet ka 3 vite i aktivizuar në Komitetin Shqiptar të Helsinkit por ndërkohë nuk mund të mos konsiderohet se nuk mbulohet aktivizimi i tij si anëtar i i Qendrës Europiane të Avancuara për Sigurinë "George C. Marshall" Gjermani dhe si anëtar i Shoqatës George C. Marshall Shqipëri, që nga viti 2006 kur është diplomuar në këtë Qendër, dhe aktualisht është i angazhuar pa ndërprerje në aktivitetet e realizuara nga Zyra ALUMNI e kësaj Qendre dhe dega e saj Shoqata George C.Marshall në Shqipëri ku dhe që prej datës 9.11.2015 është anëtar i Bordit drejtues të saj .
- Gjithashtu edhe lidhur me ushtrimin e profesionit të avokatit në kohën e kandidimit , vërehet se gjatë kohës që është i angazhuar në KSHH, kandidati nuk është në pengesë të kushtit ligjor sipas paragrafi të dytë të gërmës "dh" të pikës 2 të nenit 152 sipas të cilit "mund të ushtrohet profesioni i avokatit edhe për të 2 vitet e fundit më kohën e kandidimit përjashtimisht të rastit kur kandidati është i angazhuar në organizata ose klinika që ofrojnë ndihmën ligjore falas për funksion të organiztaës ku punojnë. Referuar dokumentacionit provues të kandidatit, rezulton se ai është i punësuar në KSHH kundrejt kontratës individuale dhe detyrimeve e të drejtave sipas legjislacionit të aplikueshëm të punësimit në Shqipëri.

Për sa më lart, Sekretari i Përgjithshëm ka vlerësuar se kandidati është në kushtet e plotësimit të kriterëve ligjore të nenit 152 të ligjit 115/2016.

2. Kandidatja Mimoza Qinami

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidates, pavarësisht procedurës së ndjekur nga Komisioni i Shoqërisë Civile, u vlerësua të kërkohej dokumentacion plotësues në lidhje me aktivitetet dhe produktet konkrete të kandidates në angazhimin dhe kontributet e saj në shoqërinë civile, dokumentacion plotësues i cili u depozitua nga kandidatja dhe u administrua në dosjen e saj.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidatja Mimoza Qinami plotëson kushtet ligjore të nenit 152 të ligjit 115/2016, për të qenë kandidat për anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ky është një vlerësim që gjendet i njëjtë edhe me vlerësimin e ONM.

4. Kandidati Alfred Balla:

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatit ka rezultuar se pavarësisht vlerësimit të Komisionit të Shoqërisë Civile, ishte e nevojshme qartësimi i dokumentacionit provues që vërteton plotësimin e kushtit ligjor referuar gjermës “d” të pikës 2 të nenit 152 të ligjit 115/2016, sipas të cilit: *“Kandidati në kohën e kandidimit, të jetë i punësuar ose i angazhuar për të paktën 5 vjet, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme pa ndërprerje, në një organizatë të shoqërisë civile për fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut”*.

Në përgjigje të shkresës nr.2054/25, datë 08.01.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm, për plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit, kandidati ka paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor 5 ditor për plotësimin e dokumentacionit.(shkresa 2054/28, datë 9.1.2018)

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Alfred Balla plotëson kushtet ligjore të nenit 152 të ligjit 115/2016, për të qenë kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ky vlerësim është i ndryshëm nga ai i ONM-së, ndërkohë që argumentet që përmend ONM për këtë kandidat janë si më poshtë :

“Përveç faktit që ky kandidat nuk i plotëson kriteret ligjore të përmendura në nenin 152.2.d), vëzhguesit ndërkombëtarë kanë konstatuar se platforma e paraqitur nga ky kandidat është pothuajse plotësisht një plagjiaturë e një platforme të paraqitur nga një kandidat tjetër (Plarent Ndreca), aplikimi i të cilit u refuzua në fazat e mëparshme të procesit duke qenë se nuk i plotësonte kriteret formale”.

“Për këtë arsye, Vëzhguesit Ndërkombëtarë janë të mendimit se ky kandidat nuk ka integritet të lartë moral që shpresohet nga një anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Në vlerësimin e Sekretarit të Përgjithshëm argumentet e ONM nuk përbëjnë kusht për konsiderimin e tij për dy arsye:

- 1.) Lidhur me plotësimin e kushtit ligjor referuar gjermës “d” të pikës 2 të nenit 152 të ligjit 115/2016, sipas të cilit: *“Kandidati në kohën e kandidimit, të jetë i punësuar ose i angazhuar për të paktën 5 vjet, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme pa ndërprerje, në një organizatë të shoqërisë civile për fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut”*sic është shpjeguar edhe më lart, kandidati në përgjigje të shkresës nr.2054/25, datë 08.01.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm, për plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit, kandidati ka paraqitur dokumentet e kërkuara (shkresa 2054/28, datë 9.1.2018).
- 2.) Të dyja këto shkresa i janë vënë në dispozicion ONM menjëherë. Në përgjigje të kërkesës, kandidati ka paraqitur dokumentacionin provues që vërteton plotësimin e kushtit ligjor konkretisht: veprimtarinë e zhvilluar nga Shoqata Avokatët Penalistë të Shqipërisë dhe angazhimin e tij gjatë pesë viteve të fundit.

- 3.) Platforma e kandidatit është element që i përket fazës së dytë të vlerësimit pasi kandidati të ketë kaluar fazën e parë të verifikimit të kushteve ligjore, pra nuk është element që përfshihet në kushtet ligjore të vendosura në ligj si dhe nuk cënon përmbushjen e kushteve ligjore. Platforma është komponent i meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale përcaktuar në nenin 132 pika 3 gërma “a” e ligjit 115/2016 citojmë : “Komisioni ad-hoc bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre organizative, drejtuese dhe menaxheriale bazuar në : a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin.
- 4.) Bazuar në nenin 35, pika 6 e ligjit 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm vlerëson kriteret profesionale morale sipas nenit 132 të ligjit vetëm për kandidatët të cilët plotësojnë kushtet ligjore. (shih më poshtë edhe vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm për pikëzimin dhe kriteret profesionale-morale sipas nenit 132 të ligjit)

KANDIDATËT QË NUK PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE DHE ARGUMENTIMI PËRKATËS

Nga dokumentacioni i paraqitur pranë Avokatit të Popullit kanë rezultuar sipas verifikimit të kryer nga Komisioni i Shoqërisë Civile se janë 11 kandidatë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të KLP-së. Sekretari i Përgjithshëm në zbatim të nenit 152 të ligjit ka verifikuar dosjet e të gjithë kandidatëve (të kualifikuar dhe të skualifikuar nga Komisioni i Shoqërisë Civile) duke shqyrtuar dokumentacionin individual në dosjen e secilit kandidat si dhe pasi ka kërkuar informacion institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, ka arritur në këtë rezultat si më poshtë:

1. Kandidatja Entela Baci (Hoxhaj)

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidates ka rezultuar se kandidatja kishte paraqitur dokumentacion të nevojshëm për të vërtetuar plotësimin e kushteve ligjore të nenit 152 të ligjit 115/2016.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidatja Entela Baci (Hoxhaj) nuk plotëson kushtet ligjore të nenit 152 pika 2, gërma “ç” të ligjit 115/2016, për të qenë kandidate për anëtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Edhe ONM ka konsideruar për këtë kandidate se nuk mund të vazhdojë kandidimin për t,u zgjedhur anëtar në KLP nga shoqëria civile referuar faktit se kandidatja është identifikuar në mënyrë të qartë nga njëri prej organeve ndihmëse të përmendura më sipër në lidhje me aftësitë profesionale dhe qëndrimin e saj, të cilat nuk janë plotësisht në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 152, pika 2, gërma ç e ligjit.

2. Lindita Xhillari

Ka shprehur interesin për anëtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e shoqërisë civile.

Bazuar në raportin e vlerësimit të Komisionit të Shoqërisë Civile, ka rezultuar se Komisioni i Shoqërisë Civile ka kërkuar në fazën fillestare të shqyrtimit të kushteve ligjore, informacion për angazhimet dhe kontributin konkret të kandidates në organizatat e shoqërisë civile për fusha të lidhura me drejtësinë dhe të drejtat e njeriut në përputhje me parashikimin e nenit 152, pika 2 “d” e ligjit 115/2016.

Kandidatja në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka paraqitur angazhimet konkrete të saj në organizatat e shoqërisë civile. Pas këtyre informacioneve Komisioni e ka kualifikuar kandidaten për të kaluar në fazën e dytë të shqyrtimit, atë të thirrjes në seancë dëgjimore të cilën e ka zhvilluar më kandidaten në datën e caktuar nga komisioni 31.8.2017)

Ndërkohë më datë 7.9.2017 Komisioni i Shoqërisë Civile ka thirrur seancë dëgjimore të jashtëzakonshme për shqyrtimin e dy kandidaturave të KLP nga shoqëria civile të cilat kanë dalë me vlerësim negativ nga ONM në vlerësimin që ata i kanë bërë këtyre dy kandidatëve gjatë kohës kur ata kanë kandiduar në organet e vetingut. Njëra nga këto kandidatura ishte ajo e Znj.Lindita Xhillari. Komisioni i Shoqërisë civile me unanimitet ka vendosur skualifikimin e kandidates Lindita Xhillari për shkak të vlerësimit negativ të ONM dhe që për rrjedhojë përbën mospërbushje të kriterit të parashikuar në nenin 152 pika 2 gërma “ç” të ligjit 115/2016 e cila shprehimisht parashikon se : “anëtari i KLP që përfaqëson shoqërinë civile në kushtet për t’u zgjedhur duhet *“të ketë një profil të spikatur shoqëror, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut”*.

Për sa më sipër, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në vlerësimin e tij është bazuar dhe në raportin e vlerësimit të Komisionit të Shoqërisë civile, si dhe në faktin që kandidatja ka ankimuar vendimin e Komisionit në Gjykatën Administrative të Apelit, ku kjo gjykatë në përfundim të shqyrtimit të padisë ka rrëzuar ankesën e kandidates dhe ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidatja Lindita Xhillari nuk plotëson kushtet ligjore të nenit 152 pika 2, gërma “ç” të ligjit 115/2016, për të qenë kandidatë për anëtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Konstandin Kazanxhi

Ka shprehur interesin për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e shoqërisë civile.

Bazuar në raportin e vlerësimit të Komisionit të Shoqërisë Civile, ka rezultuar se Komisioni i Shoqërisë Civile ka kërkuar në fazën fillestare të shqyrtimit të kushteve ligjore, informacion

për angazhimet dhe kontributin konkret të kandidatit në organizatat e shoqërisë civile për fusha të lidhura me drejtësinë dhe të drejtat e njeriut në përputhje me parashikimin e nenit 152, pika 2 “d” e ligjit 115/2016.

Kandidati në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka paraqitur angazhimet konkrete të saj në organizatat e shoqërisë civile. Pas këtyre informacioneve Komisioni e ka kualifikuar kandidatin për të kaluar në fazën e dytë të shqyrtimit , atë të thirrjes në seancë dëgjimore të cilën e ka zhvilluar më kandidatin në datën e caktuar nga komisioni 31.8.2017).

Ndërkohë më datë 7.9.2017 Komisioni i Shoqërisë Civile ka thirrur seancë dëgjimore të jashtëzakonshme për shqyrtimin e dy kandidaturave të KLP nga shoqëria civile të cilat kanë dalë me vlerësim negativ nga ONM në vlerësimin që ata i kanë bërë këtyre dy kandidatëve gjatë kohës kur ata kanë kandiduar në organet e vetingut. Njëra nga këto kandidatura ishte ajo e Z.Konstandin Kazanxhi. Komisioni i Shoqërisë civile me unanimitet ka vendosur skualifikimin e kandidatit Konstandin Kazanxhi për shkak të vlerësimit negativ të ONM dhe që për rrjedhojë përbën mospërmblidhje të kriterit të parashikuar në nenin 152 pika 2 gërma “ç” të ligjit 115/2016 e cila shprehimisht parashikon se : *“anëtari i KLP që përfaqëson shoqërinë civile në kushtet për t’u zgjedhur duhet “të ketë një profil të spikatur shoqëror, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut”.*

Për sa më sipër, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, është bazuar dhe në raportin e vlerësimit të Komisionit të Shoqërisë civile, si dhe në faktin që kandidati ka ankimuar vendimin e Komisionit në Gjykatën Administrative të Apelit, ku kjo gjykatë në përfundim të shqyrtimit të padisë, ka rrëzuar ankesën e kandidatit dhe ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Konstandin Kazanxhi nuk plotëson kushtet ligjore të nenit 152 pika 2, gërma “ç” të ligjit 115/2016, për të qenë kandidate për anëtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4. Tartar Bazaj

Ka shprehur interesin për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e shoqërisë civile. Në të njëjtën kohë ka shprehur interesin edhe për anëtar të KLGJ.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kandidatit rezulton se kandidati nuk ka vërtetuar përvojën e tij si jurist për të paktën 15 vite, në dokumentacion rezulton se ushtron profesionin e avokatit që prej vitit 2010, si dhe kandidati rezulton se ushtron në mënyrë aktive në kohën e kandidimit profesionin e avokatit (nga të dhënat e CV si dhe të dokumentacionit të avokatisë të paraqitur në aplikimin e tij, rezulton se kandidati ushtron në mënyrë të pandërprerë funksionin e avokatit), në kundërshtim me kushtin ligjor të parashikuar në nenin 152, gërma “dh” të ligjit 115/2016.

Po ashtu kandidati nuk është i mbështetur nga tre organizata të shoqërisë civile që punojnë në fushën e drejtësisë ose të drejtat e njeriut.

Kujtojmë se ky kandidat është përjashtuar nga Komisioni i Shoqërisë Civile si dhe më pas edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit sipas vlerësimit që i ka bërë kandidaturës në kandidimin e tij për anëtar të KLGJ-së për të njëjtat mosplotësim kushtesh ligjore që rezultuan edhe për kandidimin e tij për KLP.

Theksojmë se kushtet ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët për KLGJ dhe KLP janë të njëjta në të dyja rastet.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Tartar Bazaj nuk plotëson kushtet ligjore të nenit 152 pika 2, gërma “ç” gërma “dh” dhe 152 pika 4 të ligjit 115/2016, për të qenë kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

5. Mevlut Derti

Nga dokumentacioni provues për të vërtetuar plotësimin e kushtit ligjor, rezulton se kandidati nuk plotëson kushtin e vjetërsisë në punë përcaktuar në pikën 2 gërma “c” për 15 vjet vjetërsi pune në profesion si jurist.

Ky fakt është lehtësisht i provueshëm nga datëlindja e kandidatit në vitin 1984 dhe nga viti i diplomimit në vitin 2010 , diplomë e integruar e nivelit të dytë të Drejtësi, në vitin 2010.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Mevlut Derti nuk plotëson kushtet ligjore të nenit 152 pika 2, gërma “c” të ligjit 115/2016, për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

6. Bledar Ilia

Ka shprehur interesin për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e organizatave të shoqërisë civile. Kandidimi i tij është kryer njëkohësisht për të dy këshillat KLGJ dhe KLP. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati rezulton se nuk plotëson kushtin ligjor të vjetërsisë në punë sipas shkronjës“c” të pikës 2 të nenit 152 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pasi nuk përmbush periudhën 15 vjet përvojë në profesion si jurist. Referuar interpretimit dhe vlerësimit të Komisionit të Shoqërisë Civile, kandidati nuk ka arritur të sigurojë mbështetjen e shprehur nga tre organizata të shoqërisë civile, sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 152 të ligjit 115/2016.

Ky kandidat është përjashtuar për të njëjtat mosplotësim kushtesh ligjore edhe nga kandidatura e paraqitur njëkohësisht prej tij për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kujtojmë se kushtet ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët për KLGJ dhe KLP janë të njëjta në të dyja rastet.

Kandidati ka paraqitur ankim pranë Komisionit të Shoqërisë Civile. Pretendimet e kandidatit janë rrëzuar nga Komisioni duke lënë në fuqi vendimin e tyre për përjashtimin nga kandidimi si për KLGJ ashtu dhe për KLP. Kandidati nuk ka ushtruar të drejtën e tij të ankimit në gjykatë sipas parashikimeve dhe afateve ligjore.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Bledar Ilia nuk plotëson kushtet ligjore të nenit 152 të ligjit 115/2016, për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

7. Arban Tutulani

Ka shprehur interesin për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e shoqërisë civile. Nga verifikimi i dokumentacionit librezë pune nga Komisioni i Shoqërisë Civile ka rezultuar se kandidati është shkarkuar nga detyra me dekret të Presidentit të Republikës pas marrjes së masës disiplinore për shkarkim nga detyra nga Prokurori i Përgjithshëm në vitin 2002. Për këtë fakt Komisioni i Shoqërisë Civile në përfundim të procedurës së tij të verifikimit ka vendosur ta përjashtojë kandidatin për shkak se nuk plotëson kushtin ligjor sipas nenit 152, pika gërma “ç” e ligjit i cili shprehimisht përcakton se *“kandidati të ketë një profil të spikatur shoqëror, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale në fushën e drejtësisë ose të drejtat e njeriut”*.

Kandidati ka kërkuar rishikim të vendimit nga Komisioni duke sjellë edhe argumentet e tij përmes dokumenteve të tjera që nuk ishin administruar më parë nga Komisioni (*vendime të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës së Lartë që kanë njohur pjesërisht padinë duke i njohur të drejtën e dëmshpërblimit me pagimin e disa pagave por jo kthimin në detyrë*). Komisioni nuk ka marrë parasysh kërkesën për rishikim të vendimit të tij pas depozitimit të vendimeve të gjykatave nga ana e kandidatit dhe si pasojë kandidati ka ankimuar sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin e Komisionit. Gjykata ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit.

Ligji ka njohur të drejtën e ankimit të kandidatëve në fazat e vendimarrjes së Komisionit të Shoqërisë Civile ku sipas nenit 155, pika 3 të ligjit 115/2016 *“Kandidati ka të drejtë të ankimojë në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin e Komisionit të Shoqërisë Civile për përjashtimin vetëm për shkelje të rënda procedurale, dhe se vendimi i saj është përfundimtar dhe i prerë”*.

Në njohje edhe të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Apelit të vitit 2004 për masën e shkarkimit në raport me shkeljen disiplinore në ngarkim të Z.Tutulani, në atë kohë me detyrë Prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku për paditësin është provuar se ka patur shkelje disiplinore në funksion të zvarritjes së procedimeve dhe për këtë është propozuar një masë disiplinore më e lehtë se ajo që në fakt u krye, (shkarkim nga detyra) si dhe duke marrë parasysh vendimin e gjykatës së Apelit Administrativ në 2017 e cila mori në shqyrtim ankesën e paditësit, kandidatit në fjalë me objekt shfuqizimin e vendimit të Komisionit, i cili u la në fuqi, Sekretari i Përgjithshëm do ti respektojë këto vendime.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Arban Tutulani nuk plotëson kushtet ligjore të nenit 152 pika 2, gërma “ç” të ligjit 115/2016, për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

8. Bledar Bajri

Nga dokumentacioni provues për të vërtetuar plotësimin e kushtit ligjor, rezulton se kandidati nuk ka vërtetuar se plotëson kushtin e vjetërsisë në punë përcaktuar në pikën 2 gërma “c” të nenit 152 të ligjit 115/2016, për 15 vjet vjetërsi pune si jurist. Ka mospërputhje me të dhënat e deklaruara në CV ku shprehet se ushtron profesionin e avokatit që në dhjetor 2002 ndërkohë që në platformën personale të prezantuar gjatë aplikimit si kandidat, shprehet se ka filluar ushtrimin e profesionit të avokatit në vitin 2003.

Nuk ka dokumentacion provues që të vërtëtonte se ka 15 vjet jurist apo ndërkohë që në dy vitet e fundit duhet të kishte shpëputje nga avokacia. E vetma evidencë e raportuar në Cv (ky është i vetmi dokument i prezantuar nga kandidati) dëshmon se ushtron vetëm avokatinë në vijimësi duke përfshirë edhe kohën e kandidimit. Ky është një fakt që bie në kundërshtim me kushtin që kandidati dy vitet e fundit nuk duhet të ushtrojë profesionin e avokatit.

Gjithashtu është konstatuar se nuk ka dokumente të angazhimit në shoqëri civile dhe as mbështetjen e tre organizatave që punojnë në fushën e drejtësisë ose të drejtat e njeriut.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Bledar Bajri nuk plotëson kushtet ligjore të nenit 152 pika 2, gërma “c” “d” “dh” dhe pikës 4 të ligjit 115/2016, për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

9. Vladimir Vladaj

Nga dokumentacioni provues për të vërtetuar plotësimin e kushtit ligjor, rezulton se kandidati nuk plotëson kushtin e vjetërsisë në punë përcaktuar në pikën 2 gërma “c” për 15 vjet vjetërsi pune. Ky fakt është lehtësisht i provueshëm nga datëlindja e kandidatit në vitin 1989 dhe nga

viti i diplomimit të ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi “ Master i Shkencave” në vitin 2013.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Vladimir Vladaj nuk plotëson kushtet ligjore të nenit 152 pika 2, gërma “c” të ligjit 115/2016, për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

10. Vasil Shandro

Nga vlerësimi i Komisionit, nuk ka dalë e vërtetuar se kandidati ka paraqitur dokumentin diplomës sipas kërkesave të ligjit. Po ashtu nuk vërtetohet nga të dhënat e dosjes se kandidati plotëson kushtin e vjetërisë në punë me 15 vjet në profesion si jurist.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Vasil Shandro nuk plotëson kushtet ligjore të nenit 152 pika 2, gërma “c” dhe “ç” të ligjit 115/2016, për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

11. Plarent Ndreca

Nga dokumentacioni provues, Sekretari i Përgjithshëm konstaton se ndryshe nga vlerësimi i Komisionit, kandidati ka dërguar dokumente provuese të mjaftueshme që argumentojnë plotësimin e kriterëve formale ligjore. Duke qenë se vendimi i komisionit për këtë kandidat është përjashtim nga kandidimi, kandidati ankimoi vendimin e Komisionit në gjykatë. Kjo e fundit la në fuqi vendimin e Komisionit.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Plarent Ndreca nuk plotëson kushtet ligjore të nenit 152 pika 2 gërma “ç” të ligjit 115/2016, për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

12. Drita Avdyli

Nga vlerësimi i Komisionit të Shoqërisë Civile, është evidentuar se kandidatja nuk ka marrë mbështetjen e tre organizatave civile në fushën e drejtësisë. Ndërkohë nga dokumentacioni rezulton se nuk plotëson vitet e punës 15 vjet përvojë pune si juriste pasi është diplomuar me titullin jurist në vitin 2006. Ky është dhe vlerësimi i Komisionit të Shoqërisë Civile.

Në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 152 të ligjit 115/2016 si dhe bazuar në përgjigjet e institucioneve përgjegjëse të zbatimit të ligjit,

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidatja Drita Avdyli nuk plotëson kushtet ligjore, sipas nenit 152, pika 2, “c” dhe 152 pika 4 të ligjit 115/2016, për të qenë anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

➤ KONKLUZION MBI VLERËSIMIN E KANDIDATËVE TË KUALIFIKUAR DHE ATA TË PËRJASHTUAR NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM BAZUAR NË VERIFIKIMIN E KUSHTEVE KUSHTETUESE DHE LIGJORE PËR SECILIN KANDIDAT

Në përfundim të këtyre vlerësimeve pas verifikimit mbi kushtet ligjore të kandidatëve (pikat 2 -5 të nenit 35 të ligjit) dhe përgjigjet e administruara nga institucionet përgjegjëse të zbatimit të ligjit, pas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm drejtuar për informacion për të 15 kandidatët që aplikojnë për vendin vakant për një anëtar në KLP nga shoqëria civile, **Sekretari i Përgjithshëm konkludon se:**

- kualifikohen për të vijuar procedurat sipas ligjit vetëm 3 kandidatë nga 4 që kishte vlerësuar të kualifikuar Komisioni i Shoqërisë Civile të cilët plotësojnë kushtet ligjore sipas nenit 152 , dhe 12 kandidatë që përjashtohen nga Sekretari i Përgjithshëm nga 11 kandidatët që ishin skualifikuar nga Komisioni, pasi rezultojnë sipas vlerësimit të kryer nga Sekretari i Përgjithshëm se nuk plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji për t'u zgjedhur anëtar.
- Ky konkluzion nuk është i njëjtë më atë të paraqitur nga vlerësimi dhe raporti përkatës i kualifikimit dhe skualifikimit të Komisionit të Shoqërisë Civile i cili kishte vlerësuar se 4 kandidatë i plotësojnë kushtet ligjore dhe 11 të tjerë nuk i plotësojnë ato(*listat e Komisionit të Shoqërisë Civile janë listuar më lart*).
- Po ashtu ky konkluzion nuk është i njëjtë as me vlerësimin e ONM e cila sipas natyrës së saj vlerësuese ka kualifikuar vetëm 1 nga 4 kandidatët e kualifikuar nga ana e Komisionit të Shoqërisë Civile dhe ka vlerësuar se nuk mund të vazhdojnë garën 14 nga 15 kandidatët në total që aplikuan për KLP nga shoqëria civile.

ONM me shkresën nr. 2054/29 datë 12.1.2018 i dorëzoi Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit raportin tij të vlerësimit për kandidatët nga Shoqëria Civile për anëtar të KLP.

Listat e kandidatëve që sipas vlerësimit të ONM duhet të konsiderohen për vijuar kandidimin pasi plotësojnë kërkesat e parashikuara në kushtetutë dhe në ligjin 115/2016 dhe që i plotësojnë kriteret morale dhe profesionale

EMRI	MBIEMRI
1. Mimoza	Qinami

Listat e kandidatëve që sipas vlerësimit të ONM nuk duhet të konsiderohen për të vijuar kandidimin pasi nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara në Kushtetutë dhe në ligjin 115/2016

EMRI	MBIEMRI
1. Drita	Avdyli
2. Entela	Baci (Hoxhaj)
3. Alfred	Balla
4. Tartar	Baza
5. Bledar	Bajri
6. Mevlut	Derdi
7. Bledar	Ilia
8. Kostandin	Kazanxhi
9. Andi	Muratej
10. Plarent	Ndreca
11. Vasil	Shandro
12. Arban	Tutulani
13. Vladimir	Vladaj
14. Lindita	Xhillari

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRMBUSHJES SË KRITEREVE PROFESIONALE DHE MORALE SIPAS NENIT 132 TË LIGJIT NR 115/2016 PËR KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE

Referuar nenit 35 pika 6 e ligjit 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, vlerëson kriteret profesionale dhe morale vetëm për kandidatët të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ky vlerësim nga Sekretari i Përgjithshëm i kritereve profesionale dhe morale të kandidatëve për anëtar të KLP bëhet sipas kritereve të përcaktuara në nenin 132 të ligjit 115/2016.

A) Verifikimi i kritereve profesionale dhe morale sipas nenit 132 të ligjit 115/2016

Sekretari i Përgjithshëm zhvilloi më tej procesin e vlerësimit të shkallës së përmbushjes së kritereve profesionale dhe morale nga secili kandidat, të parashikuara nga neni 132 i ligjit nr. 115/2016.

Neni 132 i ligjit nr. 115/2016 parashikon në mënyrë të detajuar kriteret morale dhe profesionale mbi bazën e të cilave do të bëhet vlerësimi i kandidaturave për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

“Komisioni i Pavarur Ad Hoc bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre profesionale bazuar në:

a) rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilën kandidon;

b) vlerësimin e rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, pjesëmarrjen në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës;

c) rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë;

ç) ecurinë në punë dhe pjesëmarrjen në trajnimet profesionale dhe në kurse të tjera të certifikuara brenda dhe jashtë vendit.

2. Komisioni bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre morale bazuar në:

a) reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve;

b) cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikmëria në ushtrimin e detyrave, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi, etika profesionale, përdorimi i të gjitha mjeteve të ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave të personave që përfaqësohen prej tij;

c) angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

3. Komisioni bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre organizative, drejtuese dhe menaxheriale bazuar në:

a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;

b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;

c) aftësitë e komunikimit;

ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në mjedise multidisiplinore ose multikulturore;

d) aftësitë e përfaqësimit në publik.

4. Krahas kritereve të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, në vlerësimin e kandidatëve mbahen parasysh edhe:

a) mbajtja e titujve akademikë;

b) kryerja e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit;

c) njohja e gjuhëve të huaja."

Në bazë të nenit 35 pika 7 shkronja "c" të ligjit nr. 115/2016, në raportin për vlerësimin e shkallës së përmbushjes së kritereve profesionale dhe morale, Sekretari i Përgjithshëm mbështetet në procesin e zhvilluar, raportin si dhe dokumentacionin e përcjellë nga Komisioni i Shoqërisë Civile.

Në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, Komisioni i Shoqërisë Civile bën verifikimin paraprak të kritereve profesionale dhe morale të kandidatëve dhe i rendit në listë, sipas parashikimeve të nenit 132, të këtij ligji. Komisioni i shoqërisë civile referuar dokumentacionit të paraqitur, rezulton se ka organizuar, seanca publike dëgjimore, me 4 kandidatët që kanë plotësuar kriteret formale ligjore.

Po ashtu, këto seanca dëgjimore të kandidatëve janë kryer edhe me prezencën e përfaqësuesve nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile dhe medias.

Gjithashtu, nga dokumentacioni i përcjellë nga ana e Komisionit të Shoqërisë Civile, rezultoi se në datën 31.8.2017, ky organ bazuar në veprimtarinë e tij kolegjiale, ka vendosur miratimin për formularin tip të pikëzimit të kritereve morale dhe profesionale e kritereve të tjera të parashikuara nga neni 132 i ligjit.

Bazuar në këtë vendim, Komisioni i Shoqërisë Civile i ka paraqitur Kuvendit, vendimin e tij me pikëzimin e kritereve morale profesionale duke kryer vlerësimet individuale të çdo kandidati, për KLP nga shoqëria civile që plotëson kushtet ligjore sipas vlerësimit të Komisionit, lidhur me meritat profesionale, meritat morale, meritat organizative dhe meritat e tjera që parashikohen në nenin 132 të ligjit, pikat: 1 (gërmat a, b, c, ç) 2 (gërmat a, b, c) 3 (gërmat a, b, c, ç, d) 4 (gërmat a, b, c).

Nga ana e tij, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka hartuar vendimin nr. 8, date 17.7.2017, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin e kritereve profesionale dhe morale të kandidatëve për anetarë të KLGJ dhe KLP nga përfaqësuesit e shoqërisë civile". Kjo metodologji përmban një ndarje prej kater nivele meritash, të ndara në komponentë referuar nenit 34 dhe 132 të ligjit, secila si më poshte:

Meritat profesionale: 4 komponente të cilat përfshijnë :

- rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilën kandidon;
- vlerësimin e rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, pjesëmarrjen në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës;
- rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë;
- ecurinë në punë dhe pjesëmarrjen në trajnimet profesionale dhe në kurse të tjera të certifikuara brenda dhe jashtë vendit.

Totali i pikëve për këtë komponent është **30 pikë**.

Meritat morale: 3 komponente të cilat përfshijnë :

- reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve;
- cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikmëria në ushtrimin e detyrave, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi, etika profesionale, përdorimi i të gjitha mjeteve të ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave të personave që përfaqësohen prej tij;
- angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile

Totali i pikëve për këtë komponent është **30 pikë**.

Meritat organizative drejtuese dhe menaxheriale me 5 komponente, të cilat përfshijnë :

- cilësinë e platformës dhe vizionit që paraqesin;
- aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- aftësitë e komunikimit;
- aftësitë e të punuarit në grup dhe në mjedise multidisiplinore ose multikulturore;
- aftësitë e përfaqësimit në publik.

Totali i pikëve për këtë komponent është **20 pikë**

Merita të tjera: 3 komponentë, të cilat përfshijnë :

- mbajtja e titujve akademikë;
- kryerja e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit;
- njohja e gjuhëve të huaja.

Totali i pikëve për këtë komponent është **20 pikë**.

Totali përfundimtar për të katër kategoritë e meritave që parashikon neni 34 dhe 132 i ligjit, është 100 pikë.

V. KONKLuzionet e Sekretarit të Përgjithshëm

Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit tërësor të dosjeve individuale të kandidatëve, procesit dhe praktikës së Komisionit të Shoqërisë Civile dhe raportin e tij të vlerësimit, duke marrë në konsideratë:

- Korrespondencën me Komisionin e Shoqërisë Civile dhe dokumentacionin e përcjellë prej tij;
- Dokumentacionin individual të çdo kandidati të përcjellë nga Komisioni i Shoqërisë Civile, dokumentacionin plotësues dhe korrespondencën përgjegjëse;
- Mjetet procedurale në dispozicion të Komisionit të Shoqërisë Civile, për të vlerësuar përmbushjen e kriterëve morale dhe profesionale nga kandidatët: nëpërmjet verifikimit të plotësimin të kushteve ligjore bazuar në dokumentacionin e kandidatëve; intervistat me kandidatët; përbërjen e komisionit me përfaqësues nga Shoqëria Civile (neni 154 i ligjit) dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e Komisionit të Shoqërisë Civile të përfaqësuesve të organizatave të ndryshme që veprojnë në këtë fushë;
- Parashikimet e nenit 35 të ligjit i cili i jep të drejtën Sekretarit të Përgjithshëm të kërkojë nga kandidatët kur e konstaton të nevojshme, vetëm plotësimin e dokumentacionit që vërteton plotësimin e kushteve kushtetuese dhe ligjore ;
- Vendimin nr. 8, datë 17.7.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm "Per miratimin e rregullave për vlerësimin e kriterëve profesionale dhe morale të kandidatëve për anëtarë të KLGJ dhe KLP nga përfaqësuesit e Shoqërisë Civile".

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit jep një vlerësim të tij të pavarur nga ai i kryer nga Komisioni i Shoqërisë Civile por duke u mbështetur në procesin e zhvilluar dhe raportin e përgatitur nga Komisioni i Shoqërisë Civile, kjo në respektim të nenit 35, pika 7, shkronja "c", ku parashikohet se citojmë: *"Një raport me shkrim ku vlerësohet shkalla e përmbushjes së kriterëve profesionale dhe morale nga secili kandidat, Sekretari i Përgjithshëm mbështetet në procesin e zhvilluar dhe raportin e Komisionit të Shoqërisë Civile."*

Kështu, për *meritat profesionale* dhe *meritat e tjera* si dhe për komponentin e platformës dhe vizionit që paraqet kandidati (pjesë e kategorisë së meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale) sic renditur në vendim bazuar në komponentët përkatës që përcakton neni 132 i ligjit, Sekretari i Përgjithshëm ka qenë në gjendje të kryejë vlerësimin e tij bazuar në dokumentacionin provues të dosjeve të çdo kandidati duke qenë se plotësimi i këtyre meritave ishte i matshëm.

Si rrjedhojë e kësaj, pikëzimi i Sekretarit të Përgjithshëm mund të rezultojë i ndryshëm nga pikëzimi i Komisionit të Shoqërisë Civile.

Për pjesën tjetër të meritave morale dhe atyre organizative, drejtuese dhe menaxheriale, të përcaktuara në nenin 132, pika 2 dhe 3 të ligjit 115/2016, të cilat janë të pamundura për t'u vlerësuar në bazë të dokumentacionit të paraqitur, Sekretari i Përgjithshëm mban në konsideratë përbërjen e Komisionit të Shoqërisë Civile me përfaqësues të Shoqërisë Civile, duke gjykuar që vlerësimet për këto merita bazohen në faktin që kandidatët vijnë nga e njëjta fushë veprimtarie të përcjellë nëpërmjet këtyre anëtarëve.

Pikërisht për këtë arsye ligji ka parashikuar ngritjen e Komisionit të përbërë vetëm nga anëtarë të shoqërisë civile, i cili ka si kompetencë verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve që do të përfaqësojnë shoqërinë civile në organet e reja të sistemit të drejtësisë. Në çdo rast, Komisioni mbetet organi i pajisur me të gjithë instrumentet e nevojshëm për të përcjellë informacion për çdo kandidat, në funksion të procesit përzgjedhës, sipas ligjit nr. 115/2016 duke përbërë një “vlerë të shtuar” në garancitë që ofrohen për të pasur një proces real të përzgjedhjes.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në respektim të parashikimeve vlerësoi se:

Kandidati Andi Muratej:

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidati ka përfunduar ciklin 4-vjeçar të studimeve të larta në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës me rezultate të larta.

Që prej periudhës së diplomimit në vitin 2002 por dhe më herët është angazhuar për një kohë të konsiderueshme në organizatën e të drejtave të njeriut, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në detyra të ndryshme si kordinator projektsh, korrespondent, menaxher, ekspert dhe avokat.

Po ashtu angazhimi i kandidatit ka vijuar edhe në organizata të tjera më rol në fushën e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë.

Në bazë të dosjes individuale rezulton se kandidati është autor i disa studimeve dhe publikimeve në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Kandidati ka marrë pjesë në shumë trajnime, konferenca dhe seminare të organizuara nga organizata të shoqërisë civile brenda dhe jashtë vendit për të cilat ka dhe certifikata si dhe programe në institucione akademike pasuniversitare.

Ka paraqitur një platformë të mirëstrukturuar dhe të kompletuar e cila tregon për vizion dhe njohuritë për angazhimet që do të ketë në kuadër të ushtrimit të funksionit për të cilin kandidati po aplikon.

Referuar dosjes së kandidatit rezulton se ai ka njohuri të gjuhës angleze dhe turke të certifikuara me dëshmi.

Vlerësimi i Sekretarit të Përgjithshëm për meritat :

Për meritat profesionale kandidati u vlerësua me 29/30 pikë.

Për meritat morale u vlerësua me 21/30 pikë.

Për meritat organizative/drejtuese/menaxheriale u vlerësua me 14.5/20 pikë.

Për meritat e tjera, kandidati u vlerësua me 14.5 pikë/20 maksimumi .

Në total kandidati vlerësohet me : 79 pikë.

Ky pikëzim është i thujse i njëjtë me pikëzimin përfundimtar që ka vlerësuar Komisioni i Shoqërisë Civile (i cili e ka vlerësuar në total me 79,5 /100 pikë maksimumi)

Kandidatja Mimoza Qinami:

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidatja ka përfunduar ciklin e përshpejtuar të studimeve të larta në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës me rezultate të mira.

Kandidatja është angazhuar si eksperte pranë disa organizatave të shoqërisë civile, në fushën e veprimitarisë së të cilave është mbrojtja e të drejtave të grave.

Ne bazë të dosjes individuale rezulton se kandidatja ka marrë pjesë në trajnime profesionale brenda vendit.

Gjithashtu është licencuar si ndërmjetëse nga Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Ka paraqitur një platformë të gjatë që përshkruan disa nga problemet kryesore me të cilat përballlet aktualisht Prokuroria Shqiptare si dhe ka parashtruar zgjidhjet e mundshme për zbatim.

Rezulton se ka njohuri të gjuhës angleze.

Vlerësimi i Sekretarit të Përgjithshëm për meritat :

Për meritat profesionale kandidati u vlerësua me 23/30 pikë.

Për meritat morale u vlerësua me 24/30 pikë

Për meritat organizative/drejtuese/menaxheriale u vlerësua me 16/20 pikë.

Për meritat e tjera, kandidati u vlerësua me 15 pikë/20 maksimumi).

Në total kandidati vlerësohet me 78 pikë.

Ky pikëzim është i thujse i njëjtë me pikëzimin përfundimtar që ka vlerësuar Komisioni i Shoqërisë Civile (i cili e ka vlerësuar në total me 79 /100 pikë maksimumi)

Kandidati Alfred Balla:

Diplomuar në fakultetin e Drejtësisë në vitin 1991. Me përvojë 26 vjecarë si jurist, nga një përvojë të konsiderueshme në sistemin e prokurorisë, ku prokuror sektori gjyqësor, zv.prokuror rrethi, 10 vite avokat privat, ndërmjetësues, inspektor në Departamentin e Antikorrupsionit në KM, dhe 5 vitet e fundit këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Master në shkencë penale, pedagog për 7 vjet i lëndëve procedurë civile dhe penale, angazhim në dy shoqata ku në Shoqatën e Penalistëve ka kontribut të spikatur me pjesëmarrje dhe certifikata mirënjohje.

4 botime shkencore , kualifikime profesionale avokati dhe ndërmjetësues, disa trajnime jashtë dhe brenda vendit certifikata mirënjohje për kontributet nëpër organizata.

Vlerësimi i Sekretarit të Përgjithshëm për meritat :

Për meritat profesionale kandidati u vlerësua me 28/30 pikë.

Për meritat morale u vlerësua me 20/30 pikë.

Për meritat organizative/drejtuese/menaxheriale u vlerësua me 17/20 pikë.

Për meritat e tjera, kandidati u vlerësua me 15 pikë/20 maksimumi .

Në total kandidati vlerësohet me: 80 pikë.

Ky pikëzim është i ndryshëm me pikëzimin përfundimtar që ka vlerësuar Komisioni i Shoqërisë Civile (i cili e ka vlerësuar në total me 63 /100 pikë maksimumi)

Për sa më lart , paraqitet ky total pikësh për secilin nga kandidatët :

	Kandidati	Meritat profesionale	Meritat Morale	Meritat organizative/drejtuese/menaxheriale	Merita te tjera	Totali
1.	Alfred Balla	28	20	17	15	80
2.	Andi Muratej	29	21	14.5	14.5	79
3.	Mimoza Qinami	23	24	16	15	78

Në përfundim, Sekretari i Përgjithshëm bazuar në:

- ✓ Argumentimin e mësipërm;
- ✓ Vendimin nr.8, datë 17.7.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm për pikëzimin e kriterëve;
- ✓ Vlerësimin e detajuar me pikë të përmbushjes së kriterëve profesionale dhe morale nga kandidatët të kryer nga Komisioni i Shoqërisë Civile pranë Avokatit të Popullit;
- ✓ Nenit 35 pika 7 gërma “c” sipas të cilit Sekretari i Përgjithshëm vlerëson shkallën e përmbushjes së kriterëve profesionale dhe morale nga secili kandidat që ka plotësuar kushtet ligjore
- ✓ Dokumentacioni tërësor i dosjeve individuale të kandidatëve;

Konkludon se renditja e kandidatëve sipas shkallës së plotësimit të kriterëve sic paraqitur në tabelën totale sa më lart, rezulton si më poshtë:

- 1. Alfred Balla**
- 2. Andi Muratej**
- 3. Mimoza Qinami**

VI. PËRCJELLJA E VLERËSIMIT NGA OPERACIONI NDËRKOMBËTAR I MONITORIMIT

Në bazë të nenit 287 pika 3 të ligjit 115/2016, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit përcolli vlerësimin e kandidatëve për t'u përzgjedhur nga përfaqësuesit e shoqërisë civile për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me shkreswn Nr 2054/29 datë 12.01.2018. Në bazë të pikës 4 të po këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm në listat e kandidatëve që plotësojnë kushtet përcaktuara në Kushtetutë dhe ligj dhe kandidatëve të përjashtuar (listat sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës

7 të nenit 35 të ligjit) që i përcjell Komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, reflekton vlerësimin e përcjellë nga ONM sipas pikës 3 të nenit 287 të ligjit 115/2016.

Bazuar në këtë detyrim ligjor, pas vlerësimit të bërë nga ONM dhe krahasimit të këtij vlerësimi me vlerësimin e bërë nga Sekretari i Përgjithshëm, rezulton se lista kandidatëve që plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm është e ndryshme nga lista e kandidatëve që rezulton nga raporti i ONM-së, rrjedhimisht, edhe lista e kandidatëve të përjashtuar është e ndryshme nga ajo e ONM:

-Lista e Sekretarit të Përgjithshëm për kandidatët që sipas vlerësimit të tij plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe nga ligji përbëhet prej tre kandidatësh të kualifikuar ndërsa lista e kandidatëve që sipas vlerësimit të tij nuk plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe nga ligji përbëhet prej 12 të përjashtuar (bashkëlidhur këtij raporti 2 listat e kandidatëve të kualifikuar dhe të përjashtuar)

-Ndërkohë lista e ONM për kandidatët që sipas vlerësimit të tij plotësojnë kushtet ligjore përbëhet nga vetëm një kandidat ndërsa lista e kandidatëve që sipas ONM nuk i plotësojnë ato përbëhet 14 kandidatë.

PËRFUNDIME

Në përfundim të këtij procesi vlerësimi, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në pikën 9 të nenit 35, si dhe pikës 4 të nenit 287 të ligjit, këtë raport, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore, listën e kandidatëve të përjashtuar, si dhe kopjen e listave të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit së bashku raportin e tij të vlerësimit, si dhe dokumentacionin për secilin kandidat, do t'ia përcjellë brenda afatit ligjor, Komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend.

Bashkëlidhur këtij raporti gjenden lista emërore e kandidatëve që plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore si dhe lista e kandidatëve të përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

Në respekt të përcaktimit ligjor të nenit 35, pika 9 të ligjit nr.115/2016, listat dhe raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, do të bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të Kuvendit.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



Lista e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e Shoqërisë Civile, që plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara nga Kushtetuta dhe neni 152 i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sipas vlerësimit të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në nenin 35, pika 7, shkronja “a” të ligjit 115/2016

(sipas rendit alfabetik të emrit)

1. Alfred Balla
2. Andi Muratej
3. Mimoza Qinami



Lista e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e Shoqërisë Civile, që nuk plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara nga Kushtetuta dhe neni 152 i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sipas vlerësimit të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në nenin 35, pika 7, shkronja “b” të ligjit 115/2016

(sipas rendit alfabetik të emrit)

1. Arban	Tutulani
2. Bledar	Bajri
3. Bledar	Ilia
4. Drita	Avdyli
5. Entela	Baci (Hoxhaj)
6. Lindita	Xhillari
7. Kostandin	Kazanxhi
8. Mevlut	Derti
9. Plarent	Ndreca
10. Tartar	Bazaj
11. Vasil	Shandro
12. Vladimir	Vladaj